



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**RREGULLORE (ZKM) NR. 12/2026 PËR PLOTËSIMIN DHE
NDRYSHIMIN E RREGULLORES (ZKM) NR. 06/2026 PËR
ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE
TË PUNËS NË INSPEKTORATIN QENDROR TË MBIKËQYRJES SË
TREGUT¹**

¹ Rregullorja (ZKM) Nr. 12/2026 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores (ZKM) Nr. 06/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, miratuar me Vendimin Nr. 134/2026, të datës 05.08.2026 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 4 (2) të Ligjit Nr. 08/L 279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut , nenit 9 (1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe nenit 9 (7) të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 Për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin Në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR.12/2026 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (ZKM) NR. 06/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË INSPEKTORATIN QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (ZKM) Nr. 06/2026 Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së tregut.

Neni 2

Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 4 i nenit 4 të Rregullores bazë në tekstin si në vijim:

4. Numri i të Punësuarve në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është njëqind e dhjetë (110) nëpunës.

Neni 3

Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 4 i nenit 6 të Rregullores bazë në tekstin si në vijim:

4. Numri i nëpunësve në këtë Divizion është njëqind e tre (103) nëpunës.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

05 Gusht 2026

Shtojca 1

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Nr.	Tot.
1. Zyra e Kryeinspektorit				2
Kryeinspektori	Drejtues i Nivelit të Lartë			1
Asistent Administrativ	Profesional 3	64 Gr. i Administrimit të përgjithshëm		1
2. Divizioni i Inspektimeve				103
Udhëheqës i Divizionit të Inspektimeve	Drejtues i nivelit të ulët			1
Inspektor i Tregut	Profesional 1	63. Gr. i Administrimit të përgjithshëm		102
3. Divizioni për çështje administrative				5
Udhëheqësi i Divizionit për çështje administrative	Drejtues i nivelit të ulët			1
Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	1. Grupi ligjor		3
Zyrtar për përpunimin e raporteve financiare	Profesional 2	2. Grupi i buxhetit dhe financave		1
				110

